



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 274 Dt. 07-05-2021
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Prishtinë, 07.05.2021

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK), të datës 19.02.2017, Rregulloren Disiplinore të FBK-së të datës 06.09.2008, dhe Propozicionet e Garave (Edicioni Garues 2020/2021), si dhe në bazë të Ankesës së KB Peja të datës 06.05.2021, Komisioni i Arbitrazhit të FBK-së, me datë 07.05.2021 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Peja e datës 06.05.2021;
- II. APROVOHET PJESËRISHT Ankesa e KB Peja e datës 06.05.2021;
- III. ANULOHET Pika 9 e Vendimit të Komesarit të Garave Nr. 266 i datës 05.05.2021, përkitazi me z. Brandon Walters;
- IV. MBETET NË FUQI Pika 10 e Vendimit të Komesarit të Garave Nr. 266 i datës 05.05.2021, përkitazi me z. AJ Walton.

A R S Y E T I M

Më datë 06.05.2021, Komisioni i Arbitrazhit të FBK, përmes postës elektronike, nga sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Peja të datës 06.05.2021 (tash e tutje "Ankesa"), e cila ka të bëjë me Vendimin e Komesarit të Garave Nr. 266 i datës 05.05.2021 (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me incidentin e ndodhur më 04.05.2021 në mes të KB Peja dhe KB Ponte Prizreni.

Në këtë kuadër, Komisioni Arbitrazhit, ka mbajtur dy takime, përkatësisht më datë 06.05.2021 dhe 07.05.2021, dhe ka trajtuar Ankesën e KB Peja, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës.

KB Peja në Ankesë sfidon pikat 9 dhe 10 të Vendimit, që ndërliiden me lojtarët Brandon Walters (KB Peja) dhe AJ Walton (KB Peja), duke cilësuar veprimet e tyre si akte të vetëmbrojtjes, në përputhje me Nenin 13 të Rregullores Disiplinore të FBK-së.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku C3 (Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



RUGOVE GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Komisioni i Arbitrazhit gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha provat dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsytet në vijim.

Nga provat përkatëse, e veçanërisht video incizimet e incidentit, shihet qartë se z. Brandon Walters sulmohet fizikisht nga dikush nga turma e personave të mbledhur afër daljes nga salla. Në reagim të goditjes së pranuar, dhe në vetmbrojtje, si të cilësuar nga Komisioni i Arbitrazhit, është përfshirë në përlëshjen që kishte pasuar. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron se veprimet e z. Walters ishin brenda proporcionalitetit të paraparë sipas Nenit 13 të Rregullores Disiplinore. Prandaj, Komisioni vlerëson dhe vendosë që Pika 9 e Vendimit të Komesarit të Garave të anulohet dhe z. Brandon Walters t'i lejohet vazhdimi i angazhimit në KB Peja pa pengesa.

Në anën tjetër, po të njejtat prova tregojnë se z. AJ Walton është përfshirë në përlëshjen në fjalë, dhe sipas video incizimeve, shihet qartë se ka tejkalar masën e përdorimit të forcës proporcionale që lejohet sipas Nenit 13 të Rregullores Disiplinore, duke vazhduar përlëshjen edhe pas ndërhyrjes së personave zyrtar. Pra, nga provat shihet se lojtari në fjalë vazhdon përlëshjen edhe pas krijimit të mundësisë për tërheqje dhe insiston në vazhdimin e ballafaqimit fizik. Rrjedhimisht, Komisioni vlerëson dhe vendosë që Pika 10 e Vendimit të Komesarit të Garave të mbetet në fuqi dhe z. AJ Walton të zbatohet ndëshkimin e shqyrtuar nga Komesari i Garave në Piken 10 të Vendimit të tij.

Prandaj, Komisioni i Arbitrazhit duke u mbështetur në atë që u tha më lart, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku C3 (Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

Komisioni i Arbitrazhit

Fidan Hamiti
Anëtar

Korab R. Sejdiu
Kryetar

Lulzim Fushica
Anëtar

Vendimi i Dërgohet:

- KB Peja
- Komesarit të Garave
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

